



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.70 prot.

Himarë, më 31.10. 2024

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ZBARDHUR NGA
ORGJINALI ,MBAJTUR NË MBLEDHJEN E RADHËS TE DATËS 31.10.2024.**

Sot më datë 31.10.2024, ora 10:30 zhvillohet mbledhja e radhës të këshillit Bashkiak Himarë. Mbledhje e hapur.

Të ftuar kryetari Bashkisë, drejtoritë, kryetarët e fshatrave, administratorët e njësisë.

Marrin pjesë këshilltarët: 1. Aleks Llazari, 2. Timoleo Gërdhuqi, 3. Dhimitër Kapaj, 6. Elisabeta Lamaj, 7. Milto Nika, 8. Gjergji Iliadhi, 9. Thodhori Foto, 10. Artionil Shirokaj, 11. Fuat Mati, 12. Lenica Kocani, 13. Loreta Isufi, 14. Nertila Husi, 15. Afrovita Dhimojani, 16. Silva Burbo, 17. Miltiadhi Prifti, 18. Thëllëza Kokaveshi, 19. Qirjako Mërkuri

Mungojnë: 1. Artan Bala, 2. Maks Vlashi

Plotësohet Kuorumi këshilltarëve mbi 50%

Mbledhjen e hap Kryetari Këshillit Z. Dhimitër Kapaj me pikë rendi të ditës :

Jeni dakort me rendin e ditës? PO, Këshilli.

Pika 1.

Informacion mbi realizimin e treguesve ekonomike për periudhën janar – shtator

Drejtori Laert Mezani jep informacion të përgjithshëm mbi realizimin ekonomik të kësaj periudhe.

Kryetari Bashkisë Z. Vangjel Tavo:- taksat është një nga zërat e parë që kam përmendur kur kam ardhur, asnjë biznes nuk do të neget pa shpërblyer taksën deri në fund të vitit.

Znj. Silva Burbo:- Të ardhurat për 9- mujorin është 41.5%, a' mund t'a realizoni grumbullimin e të ardhurave deri në fund të vitit?

Drejtori Laert Mezani:- Referuar realizimit të taksave mujore është 41.4%, menaxhimi I aseteve është 126%, të ardhurat e Bashkisë Himarë për 9 – mujorin nga 1 miliardë e ca... në total janë realizuar 86%. Për zhvillimin ekonomik kemi vendosur të gjitha programet buxhetore. Referuar kontratave të mbeturë janë për çlyerjen e detyrimeve të prapambetura sepse kanë çështje procedure. Investimet në vazhdim janar – shtator kanë krijuar disa pengesa në nisjen e investimeve. Në 26 janar fillon buxheti i ri dhe administrata është e angazhuar për të gjitha investimet për të proceduar po kështu edhe për vendimet që ka

ndërmarrë këshilli. Duhet të dimë që dhe ndryshimet e titullarëve të Bashkisë kanë sjellë pengesa në realizimin ekonomik dhe vendimeve të marra në këshill në lidhje me buxhetin .

Znj. Afrovita Dhimojani :- Juve po thoni se ndryshimi titullarit në bashki ka sjell pengesa në prokurimet publike ,i bie që bashkia Himarë nuk ka bërë prokurime brenda 60 – ditësh ,pra këshilli bashkiak ka miratuar buxhetin e vitin 2024 dhe në lidhje me këto nuk është bërë asgjë sepse hanë ndryshuar titullarët ço thoni juve? Drejtori Laert Mezani:- muajin prill ,maj,qershori ,gusht patëm ndryshime titullarësh dhe kjo solli pengesa në lidhjen e kontratave.

Afati përfundimtar është tectori për realizimin e tenderimeve .Prokurimet janë realizuar të gjitha. Z. Artionil Shirokaj:- E dimë që ka latur probleme bashkia ,por për çfarë vjen,a funksionon në mënyrë të rregullt mbledhja e taksave dhe a jemi më efikas ndaj banorëve?

Znj. Thëllëza Kokaveshi :- çështja tabelave,çfarë kemi miratuar në 2023 më bën përshtypje realizimi buxhetit në tre pika si detyrimet për heqjen e taksave ,juve po thoni që nuk është realizuar buxheti për shkak sepse në bashki janë ndërruar titullarët dhe investimet janë zero,në gjithë këtë informacion vetëm sa ja formuluar dhe jo zbatuar.Dua të flas në lidhje me shkollat,buxheti i arsimit, viti që kaloi diskutuan dhe thamë do të investojmë dhe as kësaj radhe nuk është miratuar fondi, 10 miljon lekë janë vetëm bibliotekat dhe asgjë nuk është realizuar.

Kryetari këshillit :- Si performancën nuk është keq se është realizuar deri në 86% dhe janë për t'u falenderuar sepse është punuar dhe nuk mund të mos u'a vlerësojmë .

Z. Timoleo Gërdhuqi :- Kryetar mirë tha që është realizuar në 86% por këta nuk dinë të investojnë .

Sqaron drejtori Laert Mezani :- Buxhetin do ta formulojmë bashkërisht dhe do ta shqyrtojmë sëbashku .

Znj.Afrovita Dhimojani :- Do t'ju bëj një kërkesë se çfarë prokurimesh janë bërë. Kryetari Bashkisë:- bëni një kërkesë dhe do t'ju kthejmë përgjigje deri shtator ose tre mujorin e fundit.

Pika 2

Informacion për mylljen e sezonit turistik dhe problematikat e vrenjtur në bashki Himarë për vitin 2024

Sqaron drejtori Sokrat Kreku :- përsa i përket turizmit ishte një sezon i suksesshëm ku ja marrë dhe vendime me efikasitet nga juve si këshill.

Z. Thëllëza Kokaveshi :- Sa përqind është realizuar në buxhet për shkollat , për materialet higjeno-sanitare ?

Kryetari Bashkisë:- lutem furnizon shkollat me medikamentet higjeno – sanitare.

Drejtori Sokrat Kreku :- janë realizuar edhe pranë do të sjellim.Për muajin shtator janë bërë me donator për zgjidhje emergjente,janë realizuar.

Z. Timoleo Gërdhuqi :- Informacioni nuk ka ardhë i saktë, sa biznese kanë operuar në bashkinë tonë , sa gjoba janë çuar ,çfarë masash janë marrë?

Z. Milto Nika :- Jemi këtu për të çuar në parë të metat,dhe pyetjet e opozitës janë përmirësime përmirësimet qëndrojnë por jo të gjitha, ka çështje që nuk janë realizuar por jo sa shprehjeni , do të ketë përmirësimë për plazhet ,qeveria do të nxjerri një VKM për realizimin e kësaj hapësire dhe ne do ta sjellim ta diskutojmë me ju , vitin tjetër 50% të hapësirës të plazhit do ta miratoni ju. Këto probleme do të monitorohen.

Sqaron kryetari Bashkisë: - Çështja që ngrenë këshilltarët qëndrojnë por jo të gjitha, ka çështje që nuk janë realizuar por jo sa shprehjeni , do të ketë përmirësimë për plazhet ,qeveria do të nxjerri një VKM për realizimin e kësaj hapësire dhe ne do ta sjellim ta diskutojmë me ju , vitin tjetër 50% të hapësirës të plazhit do ta miratoni ju. Këto probleme do të monitorohen.

Znj. Silva Burbo :- Vërtet sezoni turistik nuk ja qënë aq i suksesshëm ,një problem kanë qënë kanalizimet e ujërave të zeza dhe këto shqetësimë i kanë lënë turistët, në qëndër të Himarës ndotja akustike ,diskot në orët e vona të natës,e shqetësojnë pushuesin këto , diskot të mos jenë brenda në qytet ,të jenë larg zonave të banuara ,te pjesa e kazanëve duhen dizifektuar.

Z.Fuat Mati :- Ne kemi bërë një kërkesë për nxënësit e shkollës në Shevasi në lidhje me tabelat,në rrugë duhet të çohet tabelë të kuptohet që aty ka fëmijë ,po kështu edhe në Borsh. Në zonën turistike na kanë ardhë shumë investitor,nuk i njohim investorët dhe mund të debatojmë ,në Borsh bëhet një resort që ka zënë pjesë hapësire,është bërë devijim,ka bllokuar atje , duhet parë kjo shirave,përmbytjeve.

Z.Qirjako Mërkuri :- Problem gjatë sezonit janë edhe parkimet ,njëri aks i rrugës është i zëmë nga parkimet gjithë anë e rrugës buzë detit,duhet gjetur vend për parkimet.

Pika 3

Shqyrtimi i projektvendimit për miratimin e rregullores së mbetjeve voluminoze në bashkinë Himarë

Znj.Afrovita Dhimojani :- Përsa u përket mbetje voluminoze në Bashkinë Himarë nga komisioni parimisht ramë dakort se është gjë e mirë për bashkinë por ramë dakort të na vijë e plotë si rregullore, të plotësohet sepse kjo rregullore është vetëm për individët ,duhet edhe për bizneset ,duhet edhe për mbetje inerte apo dhe të tjera.

Z. Timoleo Gërdhuqi :- Për pikën 3 dhe 4 dhe unë si parafolsja ,për pikën 3 të na sjellin të plotë planin, për pikën 4 që të bësh ndërtimë,të bëj dikush do ra kontrollojë qytetarin , duhet ta bëjë IMT lejen.

Shpjegon kryetari Bashkisë :- pyetje – përgjigje

Jeni e idesë ta bëj bashkia apo operatori privat? Përgjigjet Z. Afrovita :- Jam te bashkia , unë te pjesa se kush është më e mirë për komunitetin ,efekti ekonomik i kësaj rregulloreje? Nuk ka efekt.

Z. Miltiadhi Prifti :- Problemi kryesor ,administrata nuk ka mundësi të harxhoj lekë mënyra se si propozohet për mbetjet ,duhet njoftuar banorët,bashkia të vendos një program ,të bëhet një studim,të ketë një sistem rregulloreje për pastrimin e shkollave,fshatrave e të tj.

Neni 11 i rregullores thotë:- dorëzimi i mbetjeve vegetale dhe inerte do të ketë një institucion nga bashkia të merret me këtë pjesë Ne menduam të jetë urbanistika për menaxhimin e këtij plani,pika katër e rregullores flet.

Z.Afrovita Dhimojani :- te rregullorja për mbetjet dua të ndryshojë te neni 9 pika 1 ,kjo rregullore do të jetë përherë nga bashkia ?

Z. Timoleo Gërdhuqi :- pastrimi që kalon me tender është x vlerë,përfshihet dhe kjo ? Po:- nënkyetar Pervin Gjikuria.

E hedhim në votim ? Pyet kryetari këshillit.

Miratohet vendimi nr. 30 datë 31.10.2024 mbi miratimin e mbetjeve voluminoze në Bashkinë Himarë ,me 11 vota pro , 7 kundër , zero abstinen

Pika 4. Për miratimin e formularit TIP nuk kalon (punime që kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi, do të vijë i plotë nga bashkia)

Pika 5

Miratohet vendimi nr.31 mbi ndihmën ekonomike nga 6% për muajin gusht ,me 19 vota pro

Pika 6

Miratohet vendimi nr.32 mbi ndihmën ekonomike nga 6% muaji shtator me 19 vota pro

Pika 7

Miratohet vendimi nr.33 mbi planin ,aktivitetin dhe buxhetin e këshillit bashkiak Himarë për vitin 2025 me 19 vota pro

Të ndryshme

Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të banorëve .

Kryetari këshillit jep fjalën kryetarit e fshatit Lukovë.Kemi vjedhje në masë të gjërë në ullinjtë. Shefi komisariatit Himarë,nuk keni ankesë zyrtare për këtë çështje.

Kemi ankesë për një policë Bashkiak bën veprime që nuk janë në juridikcionin e tij.

Shefi komisariatit: nuk kemi ndonjë ankesë zyrtare për këtë çështje

Shqyrtimi kërkesës së Z. Kristo Mërkuri (çështje pronësie) nuk është kompetencë e këshillit bashkiak

Kërkesë e Z . Virion Pandeli Gjergji (çështje pronësie) nuk është kompetencë e këshillit .

Kërkesë e Z. Ridvan Hajdinit (kryetar i fshatit Borsh) shtim i sip të varrezave në mënyrë urgjente fshati Borsh (çështja i kalon drejtorisë juridike)

Kërkesë e Z.Agron Sala (çështje pronësie) nuk është kompetencë e këshillit.

Kërkesë e studentit Mikel Llaka (kërkon ti Miratohet bursë për në universitet) nuk është në kompetencë të Këshillit pasi kriteret për dhënien e bursave në bashkinë Himarë nga Ministria e Arsimit sipas vendimit nr. 666 përfitojnë vetëm sistemi i arsimit parauniversitar .

Kërkesë e Z.Kristo Mërkuri (të trajtohet me tokë bujqësore) nuk është kompetencë e këshillit.

Kërkesë e Z. Vladimir Abazit (për vendosje busti) nuk është kompetencë e këshillit

Kërkesa e Gogo Gjomemo (tufë me derra dëmtojnë ullishtet) policia hashkiake do ta marrim në shqyrtim.

Kërkesa e Koço Pula (drejtoria e urbanistikës)

Kërkesë e Mihal Ninit (vendosje kioske si invalid ,kërkon leje) nuk është kompetencë e këshillit .

Kryetari këshillit mbyll mbledhjen dhe ndërkohë këshilltarët firmosën protokollin e mbledhjes.

Sekretari

Elena Memushaj

